

të KNKK-së dhe është sistemuar në lëndën me numër BLG-804330-01.

**Burimet:** deklaratat N.N, FDH-856; deklaratat Xh.B, FDH-863; deklaratat N.N, FDH-867; deklaratat N.N, FDH-882; LBI, *Preliminar...*, FDH-3631; FDH-3631; deklaratat S.S, FDH-20093; deklaratat V.B, FDH-20095; deklaratat N.M, FDH-32158; deklaratat O.H, FDH-33632; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795; OMPF, *Mbetjet...*, FDH-15297.

---

## **Teki (Riza) Shehu**

(1949, shqiptar nga Rahoveci/Orahovac, xhamaprerës, gjashtë fëmijë)

Teki u me familje u strehuan në Teqenë e Qytetit në orët e hershme të mëngjesit së ditës së hënë [20.07.1998]. Por, në panikun që shpërtheu kur qytetarët e strehuar u detyruan nga policia të largoheshin nga Teqeja, ai u nda nga familja e vet. Ishte në grupin e njerëzve që vraponte drejt *Kadiri Xhamisë/Kadiri džamija*. Një autobлиндë serbe ia përcillte që nga dalja prej oborrit të Teqesë. Kur ky grup qytetarësh arriti te *Hamami i Vjetër/Stari Hamam [Rahovec/Orahovac]*, policët hapën zjarr nga autobllinda dhe e qëlluan Tekiun. Ka gjetur vdekjen në vend. Familjarët kanë mësuar për vrasjen e tij vetëm në muajin gusht të vitit 1998, kur u kthyen në Rahovec/Orahovac. Në muajin prill të vitit 2003, familjarët e Tekiut u njoftuan zyrtarisht se mbetjet e tij mortore ishin identifikuar. Vetëm atëherë, mësuan se kufoma e Tekiut ishte zhvarrosur nga varret pranë gropës së bërllokut në Rahovec/Orahovac. Familjarët i kanë varrosur mbetjet mortore të Tekiut më 29.04.2003, në varrezat myslimane në Rahovec/Orahovac.

**Burimet:** deklaratat N.S, FDH-13981; deklaratat S.S, FDH-20093; OMPF, *Mbetjet...*, FDH-15297; FDH, *Regjistri...*, FDH-5515.

---

## **Xhevdet (Ramadan) Ejupi**

(12.02.1978, shqiptar nga Rahoveci/Orahovac, nxënës)

Xhevdeti ka qenë nxënës i shkollës së mesme *Vuk Karadžić* në Rahovec/Orahovac. Ditën e hënë [20.07.1998], rreth orës 10:00, kur ai dhe familjarët e tij me qytetarë të tjerë u detyruan nga policia serbe të largoheshin

nga Teqeja e Qytetit, Xhevdeti me nënën Nazifen dhe vëllain Nevzatin u nisën me grupin e qytetarëve që shkonte drejt qendrës së qytetit dhe, më pas, drejt lagjes *Përroi/Potok*. Forcat serbe hapën zjarr drejt tyre. I kapluar nga paniku, Xhevdeti dhe e ëma u nisën të zbritnin shkallëve të poshtë në lagjen *Përroi/Potok*, përderisa Nevzati u nda nga ta dhe e mori drejtimin tjetër [**Rahovec/Orahovac**]. Por, pas pak, Xhevdeti ra në tokë. E kishin qëlluar me një plumb në shpinë. Menjëherë dha shpirt. Trupi i tij i pajetë ka mbetur në vendin e vrasjes. Familjarët i kanë identifikuar mbetjet mortore të Xhevdetit, vetëm më 10.10.1999, falë rrobave dhe gjësendeve të tij personale, që u gjetën pranë kufomave të zhvarrosura nga varrezat pranë gropës së bërllokut [prapa varrezave myslimane] në Rahovec/Orahovac. I vëllai Nevzati i ka njohur rrobat e Xhevdetit, orën e dorës dhe çelësat. Familjarët i kanë varrosur mbetjet mortore të Xhevdetit në varrezat myslimane në Rahovec/Orahovac, më 11.10.1999.

**Burimet:** deklaratat N.N, FDH-883; deklaratat N.E, FDH-32455; LBI, *Preliminar...*, FDH-3631.

---

## **Xhyllferije (Shaban) Hasanmera**

(1920, shqiptare nga Rahoveci/Orahovac, amvise, katër fëmijë)

Xhyllferija jetonte në bashkësi familjare me djemtë dhe familjet e tyre. Ishte e palëvizshme në pleqëri. Në mëngjesin e datës 20.07.1998, familjarët e saj shpejtonin për ta braktisur shtëpinë. Djemtë dhe nipërit e saj e kanë marrë Xhyllferijen dhe ishin nisur drejt Teqesë së Qytetit. Kanë hyrë në Teqenë në çastin kur policia nisi t'i detyronte qytetarët të dilnin në rrugë. E kanë lënë Xhyllferijen te Sheh Muhedini [**Rahovec/Orahovac**] dhe pastaj u larguan shpejt nga qyteti. Nga kjo ditë, nuk e kanë parë Xhyllferijen kurrë më. Trupi i saj nuk është gjetur ende. Familjarët nuk e kanë paraqitur rastin e saj te KNKK.

**Burimet:** deklaratat Xh.J, FDH-40583; deklaratat N.N, FDH – 881; J. Osmani, *Krimet...*, II, 241.

---

## **Ylfete (Abdyl) Mullaabazi**

(1933, shqiptare nga Rahoveci/Orahovac, amvise, pesë fëmijë)